

VENDIM
Nr. 449, datë 19.6.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 183, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES
TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE ‘BLUE
2’, I CILI NUK PËRFITON NGA MASAT MBËSHTETËSE, NË ZONËN SHEQ-
MARINAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I
SHOQËRIVE ‘BLESSED INVESTMENT’ SHPK DHE ‘MATRIX KONSTRUKSION’
SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “ç”, e pikës 1, të vendimit nr. 183, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse ‘Blue 2’, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq-Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ‘Blessed Investment’ sh.p.k. dhe ‘Matrix Konstruksion’ sh.p.k.”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Kapaciteti i instaluar: 100 mw;”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama